
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA

Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

Objekti i procedurës: “Blerje bateri për kabinetet hermetike”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):

31440000- 2 Bateri

Vlera e fondit limit: 4,032,000 (katër milion e tridhjetë e dy mijë) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar ku parashikohet se “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës” dhe nenin 43 pika 2/c, nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: “4. Në këtë lloj

procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturat përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, nenit 40 “Kërkesa të

veçanta për kontratat e mallrave” pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*; dhe neni 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar” pika 4 germa “b” ku përcaktohet se: *Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues në fushën objekt prokurimi, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog ose skedë teknike të lëshuar nga prodhuesi për mallin e ofruar, ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: *“4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”* dhe në nenin 40 pika 6 germa “b” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë”*;

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar artikullin e kërkuara si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike të mallit të ofruar nga operatori ekonomik.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 “Mbi Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë” / ose ekuivalent (të vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit), në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit” dhe të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit të artikujve objekt prokurimi në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor përfitues.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoritetet Kontraktore përfituese.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikimet teknike për blerjen e “Bateri për Kabinetet Hermetike”

1. Bateri hermetike 12V, 100Ah

A. Karakteristikat kryesore

• Teknologjia	AGM/VRLA
• Dimensionet (mm):	395x108x275
• Tensioni nominal	12 V
• Kapaciteti:	100Ah
• Pesha	33 Kg
• Performanca12FIT101	C10 to 1.80V/cel ne 20°C
• Tensioni i karikimit constant (Constant Voltage Charge)	Po
• Rryma maksimale e ngarkimit	25 Ah
• Rryma e qarkut të goditjes	2750 A
• Rezistencë e brendshme	4.6 mΩ
• Terminali	M8
• Termialet lidhëse me ngjyra të diferencuara (Pol+ Pol-)	Po

B. Standartizimi


- ISO 9001 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë
- ISO 14001 – Sistemi i menaxhimit të mjedisit
- IEC 60896 Pjesa 21 - Metodat e testimit VRLA
- IEC 60896 Pjesa 22 - Kërkesat e VRLA
- BS6334 / UL 94 V0 ndezshmëria e materialeve
- Eurobat >12 vjet JETË

C. Karakteristikat teknike të baterisë:

- Kapakët e baterisë kane hapesirë për kabllot e lidhjes së baterisë
- Dizajni lejon lidhjen e kablllove në pjesën e sipërme, të përparme
- Të kenë doreza/litar për lehtësi transportimi
- Plastika e jashtme me mure të trasha, për enën dhe kapakun e baterisë, është projektuar për qëndrueshmëri mekanike të lartë.
- Mbyllja me saldim termik i enës me kapakun, është projektuar për të shmangur rrjedhjen e elektrolitit në një gamë të gjerë temperaturash.
- Pllaka dhe rrjeta të ngjitura nga aliazh plumb-kallaj-kalcium i cilësisë së lartë.
- Qelizat e brendshme janë të pajisura me valvola sigurie një drejtimësh, për të lejuar daljen e gazrave të tepërt kur janë të mbingarkuara.
- ABS IEC 707 FV0 dhe UL 94 V0 (LOI më i madh se 28%) plastika retardante nga zjarri
- Elektroliti i përthithur plotësisht në ndarësit AGM prej xhami me porozitet jashtezakonisht të lartë.
- Terminalet të filetuar me materjal bronxi, garantojnë përcueshmeri të lartë, mbajtje maksimale të çift rrotullues dhe instalim të lehtë.

D. Kërkesa specifike:

- Montimi i baterive 4(katër) cop për pikë repertitore.
- Pikë repertitore kabinet Datacom hermetik.
- Grupimet e baterisë (4cop) të shoqërohen me elementet përkatës të montimit në seri.



II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar dhe miratuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i autoritetit kontraktor përfituese sipas nevojës që ka për artikullin objekt prokurimi, në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, duke argumentuar si më poshtë:

Bateritë objekt prokurimi do të përdoren si pjesë zëvendësuese të sistemeve të furnizimit me energji të infrastrukturës dhe sistemeve ekzistuese të Policisë së Shtetit, të instaluar në kabinetet hermetike, të shpërndara në pika (site) në të gjithë territorin vendit ku ka shtrirje kjo infrastrukturë. Për këtë arsye, specifikimet teknike janë përcaktuar në funksion të konfigurimit ekzistues të sistemeve, karakteristikave të pajisjeve ku ato do të instalohen, hapësirës fizike të disponueshme dhe kërkesave elektrike të sistemit.

Në kabinetet hermetike ekzistuese përdoret furnizim me energji 220/230 V AC, ndërsa sistemi i energjisë rezervë funksionon me 48 V DC. Ky tension realizohet nëpërmjet lidhjes në seri të baterive 12 V, me kapacitet 100 Ah, sipas konfigurimit të sistemit ekzistues. Për këtë arsye, bateritë zëvendësuese duhet të jenë të përshtatshme me këtë konfigurim dhe me pajisjet ekzistuese të furnizimit dhe menaxhimit të energjisë.

Përcaktimi i parametrave teknikë të baterive është i domosdoshëm për arsyet e mëposhtme:

- Përmasat 395 x 108 x 275 mm janë përcaktuar në funksion të hapësirës fizike dhe konfigurimit të brendshëm të kabineteve hermetike ekzistuese. Bateria duhet të vendoset në hapësirën e parashikuar pa ndërhyrje ose modifikime në strukturën e kabinetit, mbajtëset dhe komponentët ekzistues.*
- Pesha rreth 33 kg lidhet me konfigurimin fizik të baterisë dhe kërkesat konstruktive të instalimit. Ndryshimi i konsiderueshëm i peshës ndikon në mënyrën e fiksimit dhe sigurinë mekanike të baterisë brenda kabinetit.*
- Tensioni nominal 12 V dhe kapaciteti 100 Ah janë përcaktuar në përputhje me konfigurimin ekzistues të sistemit të energjisë rezervë. Bateritë janë të lidhura në seri për të realizuar bankën e baterive me tension 48 V DC. Për këtë arsye, ndryshimi i këtyre parametrave do të sillte papajtueshmëri me konfigurimin ekzistues të sistemit të furnizimit me energji.*
- Rezistenca e brendshme 4.6 mΩ është një parametër i rëndësishëm për performancën elektrike të baterisë dhe aftësinë e saj për të përballuar ngarkesat e kërkuara. Një*

rezistencë më e lartë mund të shkaktojë rënie më të madhe të tensionit dhe humbje gjatë ngarkesave, duke ndikuar në performancën dhe sigurinë e sistemit.

- Rryma e shkurtër 2750 A është një parametër i domosdoshëm në funksion të karakteristikave të sistemit të energjisë dhe kushteve konkrete të operimit të infrastrukturës. Bateritë janë të instaluara në pika repetitore të shpërndara në terren, përfshirë zona maloredhe të vështira për akses, ku ndërprerjet e furnizimit me energji elektrike janë relativisht të shpeshta dhe mund të zgjasin për periudha të konsiderueshme.
- Terminali M8 është përcaktuar në përputhje me konfigurimin ekzistues të lidhjeve elektrike dhe kablllove të sistemit të furnizimit me energji të kabineteve hermetike. Përdorimi i një terminali tjetër do të kërkonte përshtatjen ose zëvendësimin e kablllove elektrikë, konektorëve dhe elementëve të tjerë të lidhjes me baterinë. Një ndërhyrje e tillë nuk është pjesë e objektit të këtij prokurimi, i cili konsiston në furnizimin me bateri për zëvendësimin e baterive ekzistuese, dhe jo në modifikimin e instalimeve elektriketë kabineteve hermetike. Për më tepër, zëvendësimi i kablllove dhe elementëve të lidhjes do të sillte ndërhyrje shtesë në infrastrukturën ekzistuese, duke rritur kohën e ndërhyrjes, kostot dhe rrezikun e shkëputjes apo dëmtimit të pajisjeve gjatë instalimit. Për këtë arsye, kërkesa për terminal M8 është e domosdoshme për të mundësuar zëvendësimin direkt të baterive ekzistuese, pa ndryshime në instalimet elektrike dhe pa ndërhyrje shtesë në konfigurimin e kabineteve hermetike.
- Jetëgjatësia >12 vjet, sipas klasifikimit EUROBAT, është kërkuar për të garantuar jetëgjatësi dhe besueshmëri të lartë të sistemit të energjisë rezervë, duke marrë në konsideratë rëndësinë e infrastrukturës DataCom, shkëputjet e herëpashershëm të energjisëelektrike, kushtet e instalimit të kabineteve hermetike dhe nevojën për të minimizuar ndërhyrjet dhe zëvendësimet e shpeshta në pikat e instalimit.

Në tërësinë e tyre, **përcaktimi i këtyre parametra nuk synojnë të kufizojnë konkurrencën dhe as për favorizimin e një marke apo prodhuesi të caktuar**, por janë mbi bazën e kërkesave objektive të infrastrukturës ekzistuese dhe të performancës qëduhet të garantojë produkti, të domosdoshme dhe të ndërlidhur me përputhshmërinë fizike, elektrike dhe funksionale të baterive me infrastrukturën ekzistuese. Qëllimi është që zëvendësimi i baterive të realizohet pa ndryshuar konfigurimin e kabinetevehermetike, sistemin e furnizimit me energji, lidhjet elektrike apo pajisjet e tjera ekzistuese.

Sa më sipër, hartimi i kërkesave për kualifikim dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, janë hartuar nga specialistët anëtarë të njësisë së prokurimit, bazuar në nevojat e autoritetit kontraktor përfitues.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim.

NJËSIA E PROKURIMIT